



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 164, datë 27.7.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,
PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE “PËR LUFTËN
KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE DHE
TERRORIZMIT”, NË KUADËR TË STRATEGJISË KOMBËTARE
PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, përgjegjës, për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale “Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit”.
2. Ky grup pune të kryesohet nga ministri i Brendshëm dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
 - Zëvendësministrin e Financave;
 - Zëvendësministrin e Drejtësisë.

3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen, thirren të marrin pjesë:
 - titullarë të Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - titullarë nga Njësia Antitrafik;
 - përfaqësues nga Ministria e Brendshme, titullarë të strukturave në Policinë e Shtetit;
 - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndihmës së Huaj;
 - ekspertë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integritit;
 - përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme vepron si koordinator ndërmjet këtij grupi pune dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndihmës së Huaj, si dhe Ministrisë së Financave e Ministrisë së Integritit
5. Ministri i Brendshëm ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërmnistror të punës.
6. Ministri i Brendshëm, me propozimin e grupit ndërmnistror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtor i ose specialistësh të lartë, nga ministrinë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Brendshëm.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale “Për luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit”, zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrin nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.
8. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërmnistror të punës dhe të grupit teknik përcaktohen nga ministri i Brendshëm, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

9. Ngarkohet ministri i Brendshëm, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Berisha', written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.

SALI BERISHA